



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr. 1025/prot  
16

Datë, 15/05/2019

VENDIM  
Nr. 1 datë 2/5/2019

**PËR  
SHTYRJEN E VENDIMIT PËR MIRATIMIN E LEJES "PËR HAPJEN E NJË PUS-  
SHPIMI", AUTOSTRADA TIRANË-DURRËS, KM.7, KASHAR, TIRANË, PËR  
SUBJEKTIN "... te Birra STELA" sh.p.k**

Në zbatim të Ligjit Nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të ndryshuar, përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2, vendimit nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", vendimit nr.221 datë 26.04.2018 "Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" paragrafi III, pika 5 gërma "i", vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" neni 16 gërma "c", Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

**KONSTATOI SE;**

- Nga shqyrtimi i kërkesës së subjektit "...te Birra Stela" për hapjen e një pus-shpimi" me vendodhje në autostradën Tiranë-Durrës, km.7, njësia administrative Kashar, bazuar në diskutimet e anëtarëve të KBU-së, për dhënien e lejes "për hapjen e një pus-shpimi" të merren masa nga subjekti për plotësimin e kushteve të mëposhtëme:
- Rifreskimi i çertifikatës së pronësisë, së bashku me kartelën e pasurisë
- Përmirsimin e raportit hidrogeologjik në lidhje me përqindjen e sigurisë.

Për këto arsye Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

**VENDOSI**

1. Shtyrjen e Vendimit për miratimin e lejes për hapjen e një pus shpimi për ujë sanitar, për subjektin "... te Birra STELA" sh.p.k, nga shpuesi profesionist Fatos Kopaçi me vendodhje autostrada Tiranë-Durrës, Km.7, Tiranë, me këto të dhëna:

Koordinatat në KRGJSH të pusit të projektuar: X= 478642, Y=4580135, Z=56 m

- Kapaciteti i parashikuar 1 l/s
- Thellësia e shpimit të pusit 300 m
- Diametri i shpimit të pusit 0,0-150 m =Ø311 mm, 150-300 m=Ø211mm
- Qëllimi i përdorimit: Ujë sanitar

1. Ky vendim shtyhet për arsyt e mëposhtme:

- Rifreskimin e Çertifikatës së pronësisë shoqëruar me kartelën e paurisë.
- Përmirsimin e raportit hidrogeologjik në lidhje me përqindjen e sigurisë.

3. Ngarkohet ZABU Ishëm-Erzen-Mat për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi

4. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

### PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

**SEKRETAR**

**Adrian SHTINO**



**KRYETAR**

**Suzana JAHOLLARI**

